



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 12.2 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe nenit 21, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018 për Marrëdhënie Pune, Zyra Kombëtare e Auditimit, me datën 18.06.2019, publikon këtë:

SHPALLJE **për Angazhim në Punë dhe Detyra Specifike**

I. Angazhim për shërbime: Një (1) Këshilltar/ekspert për përkrahje profesionale për finalizimin e dokumentacionit për zhvillimin e Softuerit për Menaxhimin e Auditimit (SMA)”

Numri i referencës: PSHS-APDC/ZKA/01-02/19

Të drejtë aplikimi kanë shtetasit e Kosovës dhe ata jashtë Kosovës.

Përkrahja profesionale kërkohet në:

1. Shqyrtimin dhe vlerësimin e studimit të fizibilitetit për SMA;
2. Shqyrtimin e Termeve të Referencës si pjesë e procedurës së tenderit;
3. Të ndihmojë procesin e prokurimit deri në kontraktim; dhe
4. Të ndihmojë procesin e mbikëqyrjes së zhvillimit të SMA.

Për më shumë, detyrat i gjeni në faqen zyrtare të ZKA-së te pjesa “Mundësi punësimi-konkurset” .

Mënyra dhe periudha e angazhimit për shërbime në punë dhe detyra specifike është katër (4) muaj. Pagesa bëhet në bazë mujore.

Kushtet themelore për angazhimin në punë dhe detyra specifike:

- Eksperti që merr detyrën duhet të ketë minimum pesë (5) vjet përvojë në sistemet e menaxhimit të materialeve audituese përmes platformës elektronike.
- Diplomë përkatëse të avancuar universitare ose përvojë pune profesionale ekuivalente të kombinuar me diplomë universitare në një fushë të ngjashme. Niveli i parë universitar në kombinim me përvojën kualifikuese mund të pranohet në vend të nivelit të avancuar universitar.
- Çertifikatë (a) në auditim për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (ISO 9001).
- Përvoja me Analiza Biznesore për identifikimin e proceseve biznesore.

Mënyra e konkurimit:

Kandidatët e interesuar, aplikacionin zyrtar mund ta marrin në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit apo ta shkarkojnë nga ueb faqja e internetit në adresën: <http://www.zka-rks.org/> dhe mund të paraqesin dokumentacionin në kopje fizike në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në adresën: rr. “Ahmet Krasniqi” nr. 210- Prishtinë apo të aplikojnë përmes faqes së internetit në adresën: rekrutimi@oagks.org.

Kandidatët, aplikacionit duhet bashkëngjitur dëshmitë për kualifikimin shkollor, përvojën e punës, dëshmitë për kualifikimet tjera dhe kopjen e letërnjoftimit. Dokumentacioni i pakompletuar me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohet.

Shpallja është e hapur pesë (5) ditë, nga dita e publikimit në faqen e internetit të ZKA-së dhe në shtypin ditor me datën 18.06.2019 dhe mbetet e hapur deri më datën 23.06.2019. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin për Burime Njerëzore, në nr.tel. 038/606-004, ext: 1140.